



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 86/2 prot

Datë 17.01.2022

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-13907-12-03-2021, me objekt: “*Shpenzime per Shtypshkrime të Regjistrave të Mjekut*”, me fond limit 1,979,957 (një milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh., zhvilluar me datë 28.12.2021 nga autoriteti kontraktor, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Inpress” SHPK
Rruga “Vaso Pasha”, Nr.3, B1, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
Rr. “Sami Frashëri”, nr. 8, Tiranë
- Subjekti i Interesuar:** Operatori ekonomik “Kristalina KH” SHPK
“Lord Bajroni” Laprakë Tiranë

Në datën 14.01.2022 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 86/2022 protokolli dhe me numër ankimi elektronik A/2022/1807 e operatorit ekonomik “Inpress” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur e thjeshtuar*”, me Nr. REF-13907-12-03-2021, me objekt: “*Shpenzime për Shtypshkrime të Regjistrave të Mjekut*”, me fond limit 1,979,957 (një milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh., zhvilluar me datë 28.12.2021 nga autoriteti kontraktor, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Inpress” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “Inpress” SHPK, kundërshton me anë të ankesës me nr. 86 prot., datë 14.01.2022.

Konkretisht operatori ekonomik ankimues “Inpress” SHPK, është skualifikuar për arsyet si më poshtë vijon:

- *Një pjesë e mostrave të paraqitura nga ana e operatorit ekonomik nuk plotësojnë specifikimet teknike sipas kërkesave në dokumentat e tenderit si më poshtë:*
- *1)Mostra e Regjistri i vaksinimit është paraqitur me 100 fletë nga 130 që është kërkuar në DST*
- *2)Mostra e Regjistri i analizave të gjakut nuk janë respektuar distanca në kolonën e fundit sipas modelit*
- *3)Regjistri i urgjencës dhe ndihmës së shpejtë është pa numër rendor sipas specifikimeve të modelit.*
- *4)Mostra e regjistrave me Nr.rendor 9 dhe 10 distancat dhe konfigurimi sipas modeleve të kërkuara*

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 17.01.2022.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiovent Zguro